



NJOFTIM

Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror "Mito Haxhi Vasilev - Jasmin", në pajtim me Ligjin për çmime shtetërore, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për çmime shtetërore ("Gazeta Zyrtare e RM-së" numër 52/06, 54/07, 74/12, 99/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së numër 98/19), dhe nenin 8 paragrafi 3 të Rregullores së Punës, Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror "Mito Haxhi Vasilev - Jasmin", në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2019, miratoi:

VENDIM

1. Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror "Mito Haxhi Vasilev - Jasmin", vendosi në vitin 2019 që çmimi shtetëror "Mito Haxhi Vasilev - Jasmin", i cili ndahet për arritjet në fushën e publicistikës dhe gazetarisë në interes të Republikës së Maqedonisë së Veriut mos t'i ndahet asnjërit nga kandidatët e paraqitur.

2. Këshilli vendosi si në pikën 1 të këtij Vendimi, duke e pasur parasysh që asnjëri nga kandidatët nuk e mori shumicën e nevojshme të votave për të fituar çmimin shtetëror "Mito Haxhi Vasilev - Jasmin" për vitin 2019.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

**Kryetare e Këshillit
për Ndarjen e Çmimit Shtetëror
"Mito Haxhi Vasilev - Jasmin",
Katerina Blazhevskaja**